

Plagosje me armë zjarri në oborrin e një kazino në fshatin Breznicë, Policia jep detaje



15/11/2022 10:56



Policia e Kosovës ka njoftuar për një rast “Vrasje në tentativë” të raportohet në orët e hershme të mëngjesit.

Policia ka pranuar një informatë ku dyshohej se në zonën e fshatit Breznicë, jashtë territorit të Kosovës në oborrin e një kazinoje një person shqiptar, shtetas i Kosovës është plagosur me armë zjarri dhe i njëjti nga një familjar i tij është transportuar për në Spitalin Rajonal të Gjilanit.

“Njësitet Policore me të marrë informatën kanë ndërmarrë të gjitha veprimet policore ku kanë arritur që të lokalizojnë dhe të arrestojnë brenda territorit të Republikës së Kosovës nëntë persona të dyshuar shtetas të Kosovës të cilët dyshohet se janë të përfshirë në këtë incident”,thuhet në njoftimin për media, transmeton [lajmi.net](#).

Viktima në këtë rast është trajtuar në emergjencën e Spitalit Rajonal të Gjilanit dhe sipas mjekut kujdestar është jashtë rrezikut për jetë.

Njësi Rajonal i Hetimeve në koordinim të plotë me Prokurorin e Shtetit janë duke i hetuar rrethanat se si ka ndodhur rasti, i cili nga Prokurori i Shtetit është cilësuar “Vrasje në tentativë”./[Lajmi.net/](#)

Artikuj të ngjashëm




November 15, 2022

Kosova përfiton 21 projekte nga Erasmus+, Nagavci; BE-ja luan rol të...



November 15, 2022

Rama për Sali Berishën: I “nguli thikën” UÇK-së dhe Shqipërisë, priti...



November 15, 2022

Diabeti, 8% e kosovarëve të prekur, diagnostikimi në faza të vonshme



November 15, 2022

Zhduket një grua në Prizren



November 15, 2022

Ish-gjenerali amerikan: Ushtria e Kosovës mund të bashkekzistojnë me një forcë...



November 15, 2022

Hoti: Buxheti i viti 2023 është me i ulët se ai...

LAJME TË FUNDIT



“Jem bo gjyshe, jem bo vjehrra”, thotë Shyhrete Behluli në këngën e re



Kosova përfiton 21 projekte nga Erasmus+, Nagavci; BE-ja...



Jim Carrey-t i ndalohej hyrja në Rusi



Fifi dhe Markel Goga arrijnë suksesin e parë me këngën “Dehur”

Other Links